


Përmbledhje e kuadrit institucional të Bashkimit Europian për Parandalimin e Pastrimit të Parave: Njësitë e Inteligjencës Financiare

Mars 2026



RRETH KËSAJ SERIE DOKUMENTESH SHPJEGUESE

Ky dokument shpjegues është pjesë e një serie vlerësimesh tematike legislative të përgatitura nga [Transparency International EU](#). Seria ofron një përmbledhje mbi zhvillimet kryesore të prezantuara nga paketa e Bashkimit Europian kundër pastrimit të parave (AML) e vitit 2024 dhe rëndësinë e tyre për procesin në vijim të përafrimit të Shqipërisë me acquis të Bashkimit Europian, veçanërisht në kuadër të Kapitujve 23 dhe 24.

Dokumentet publikohen të përkthyer në gjuhën shqipe për të mbështetur përfshirjen e informuar të organizatave të shoqërisë civile, institucioneve akademike, gazetarëve investigativë dhe aktorëve të tjerë në proceset e konsultimit që lidhen me reformat legislative dhe institucionale në fushën e transparencës dhe integritetit financiar.

Ky dokument bazohet në përkthimin e versionit në gjuhën angleze të “EU AML Legislative Assessment”. Në rast mospërputhjesh, versioni origjinal në gjuhën angleze prevalon.

Ky dokument është përgatitur nga Transparency International EU me kërkesë të BIRN Albania në kuadër të projektit *“Follow the Money: Strengthening Albania’s Anti-Money Laundering Initiatives”*, me mbështetjen e FCDO përmes Ambasadës Britanike në Tiranë. Gjetjet e këtij dokumenti janë përgjegjësi e vetme e autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Ambasadës Britanike në Tiranë.

HYRJE

Bashkimi Europian (BE) ka zhvilluar një kuadër institucional gjithëpërfshirës për të trajtuar rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, nëpërmjet një sistemi të integruar mbikëqyrës dhe inteligjence.

Me miratimin e [Rregullores së Gjashtë kundër Pastrimit të Parave](#) (AMLR6¹), Njësitë e Inteligjencës Financiare (NJIF-et) klasifikohen zyrtarisht si autoritete kompetente, duke siguruar që të gjitha kompetencat e mëvonshme ligjore dhe të drejtat e aksesit në të dhëna të zbatohen drejtpërdrejt ndaj tyre. Rregullorja e integron sektorin privat në këtë sistem të inteligjencës financiare, duke u kërkuar subjekteve raportuese të raportojnë menjëherë dhe pa filtër transaksionet e dyshimta pranë NJIF-it të tyre kombëtar. Ajo vendos një rregull raportimi pa prag minimal dhe ndalon delegimin te palë të treta të vendimit përfundimtar për raportim, duke siguruar kështu një marrëdhënie të drejtpërdrejtë dhe të përgjegjshme ndërmjet sektorit të rregulluar dhe inteligjencës financiare.

[Direktiva e Gjashtë kundër Pastrimit të Parave](#) (AMLD6²) e plotëson këtë kuadër duke u kërkuar Shteteve Anëtare të krijojnë një njësi të vetme qendrore kombëtare, e cila të jetë operacionalisht e pavarur dhe autonome. Për të garantuar integritetin e hetimeve financiare, NJIF-et duhet të mbeten të lira nga çdo ndikim ose ndërhyrje e papërshtatshme politike, qeveritare apo e industrisë dhe të kenë kompetencën për të marrë vendime të pavarura për analizën dhe shpërndarjen e informacionit. Për më tepër, AMLD6 u jep NJIF-eve akses të menjëhershëm dhe të drejtpërdrejtë në një gamë të gjerë të dhënash, përfshirë regjistrat e llogarive bankare, të dhënat tatimore dhe bazat e të dhënave të zbatimit të ligjit. Kjo mundëson hartëzimin efektiv të rrjeteve kriminale pa vonesa procedurale.

Së fundi, [Rregullorja AMLA](#) krijon Autoritetin për Luftën kundër Pastrimit të Parave (AMLA³) si një agjenci qendrore të decentralizuar, e projektuar për t'i shtuar mbrojtjes së brendshme të Bashkimit Europian një dimension thelbësor mbikëqyrës dhe inteligjence. AMLA do të koordinojë autoritetet kombëtare për të garantuar zbatimin e njëtrajtshëm të rregullave të AML-së dhe pritet të jetë plotësisht operacionale në vitin 2028,

¹ AMLR6 - akronim për *The sixth Anti-Money Laundering Regulation*

² AMLD6 - akronim për *The sixth Anti-Money Laundering Directive*

³ AMLA - akronim për *Authority for Anti-Money Laundering and Countering the Financing of Terrorism*

kohë kur do të nisë mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të 40 subjekteve të përzgjedhura me risk të lartë. Ajo do të shërbejë gjithashtu si qendra teknike e rrjetit duke administruar *FIU.net*, platformën e sigurt për shkëmbimin ndërkufitar të informacionit.

Paketa AML krijon një urë të ndërsjellë informacioni të specializuar ndërmjet NJIF-eve dhe organeve të tjera të Bashkimit Europian, si Zyra e Prokurorit Publik Europian (EPPO⁴) dhe Zyra Europiane Kundër Mashtrimit (OLAF⁵), me qëllim mbështetjen e ndjekjes penale të veprave që prekin interesat financiare të Bashkimit Europian. Për të lehtësuar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit në fushën e zbatimit të ligjit dhe të bashkëpunimit gjyqësor, AMLA autorizohet të lidhë marrëveshje pune me institucione të ndryshme të BE-së, agjenci të decentralizuara dhe organe të tjera. Të marra së bashku, këto instrumente krijojnë një strukturë shumë-shtresore, të projektuar për të trajtuar rastet e pastrimit të parave të lidhura me korrupsionin përpara se ato të mbërrijnë në gjykim.

⁴ EPPO - akronim për *The European Public Prosecutor's Office*

⁵ OLAF - akronim për *The European Anti-Fraud Office*

RREGULLORJA AML, “KUADRI UNIK RREGULLATOR”

TEKSTI LEGJISLATIV

Rregullorja (BE) 2024/1624 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 31 maj 2024, për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit.

DISPOZITAT	SHpjegimi
Përkufizime Neni 2	
1) Për qëllimet e kësaj Rregulloreje, zbatohen përkufizimet e mëposhtme: (...) (44) “autoritete kompetent” do të thotë: (a) Njësia e Inteligjencës Financiare (NJIF)	Ky nen përcakton përkufizimet ligjore të nevojshme për kuptimin e paketës AML. Duke e klasifikuar NJIF-in si “autoritet kompetent”, Rregullorja sigurohet që të gjitha kompetencat dhe të drejtat e mëvonshme të aksesit në të dhëna që u jepen autoriteteve, t’i jepen drejtpërdrejt edhe NJIF-eve.

<p>Funksionet e përputhshmërisë Neni 11</p>	<p>Ky nen kërkon caktimin e një personi të posaçëm brenda çdo subjekti, i cili vepron si pikë kontakti me NJIF-in, duke garantuar që <i>informacioni</i> jo vetëm të mblidhet, por edhe të përcillet nga një person me “pozicion hierarkik mjaftueshëm të lartë”.</p>
<p>1) Subjektet raportuese duhet të caktojnë një person përgjegjës në nivel drejtues i cili do të jetë përgjegjës për sigurimin e përputhshmërisë me këtë Rregullore.</p> <p>2) (...) Zyrtari i përputhshmërisë (...) duhet të jetë përgjegjës për raportimin e transaksioneve të dyshimta te NJIF-i në përputhje me nenin 69(6).</p>	<p>Kjo dispozitë ka për qëllim të garantojë që informacioni i shkëmbyer me NJIF-in në kuadër të rasteve të dyshimta, të mund të arrijë të shpërndahet edhe nëpër struktura të ndërlikuara biznesi. Ajo u kërkon ndërmarrjeve mëmë të zbatojnë politika në nivel grupi që të detyrojnë degët e ndryshme të kompanisë të ndajnë midis tyre raportet e transaksioneve të dyshimta dhe analizave përkatëse, duke u siguruar që, sapo një dyshim të raportohet te NJIF-i, i gjithë grupi të vihet në dijeni dhe informacioni të përdoret për menaxhimin e riskut në juridiksione të ndryshme.</p>
<p>Kërkesat në nivel grupi Neni 16</p>	
<p>3) (...) subjektet raportuese brenda grupit duhet të shkëmbejnë informacion kur një shkëmbim i tillë është i rëndësishëm për (...) menaxhimin e riskut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Shkëmbimi i informacionit (...) mbulon identitetin dhe karakteristikat e klientit, pronarët e tij përfitues ose personin në emër të të cilit vepron klienti, natyrën dhe qëllimin e marrëdhënies së biznesit dhe të transaksioneve të rastësishme, si edhe dyshimet, të shoqëruara me analizat përkatëse, se fondet janë produkte të veprimtarisë kriminale ose lidhen me financimin e terrorizmit, të raportuara te NJIF-i sipas nenit 69, përveç rasteve kur NJIF-i udhëzon ndryshe.</p>	

Delegimi i funksioneve

Neni 18

1) **Subjektet raportuese mund t'u delegojnë ofruesve të shërbimeve detyra që rrjedhin nga kjo Rregullore.** (...)

3) (...) **Detyrat e mëposhtme nuk mund të delegohen** në asnjë rrethanë: (...)

(e) **raportimi te NJIF-i** i veprimtarive të dyshimta (...) përveç rastit kur këto veprimtari i delegohen një subjekti tjetër raportues që i përket të njëjtit grup dhe është i vendosur në të njëjtin Shtet Anëtar.

Ky nen vendos një kufi të rreptë ligjor për zinxhirin e raportimit drejt NJIF-it. Ai ndalon delegimin te një palë e tretë e jashtme të vendimit përfundimtar për raportimin e një transaksioni ose rasti të dyshimtë, duke siguruar që përgjegjësia ligjore dhe marrëdhënia e drejtpërdrejtë me NJIF-in të mbeten brenda sektorit të rregulluar, duke parandaluar kështu zbehjen e përgjegjshmërisë në transmetimin e inteligjencës financiare.

Pamundësia për të përmbushur kërkesën për ushtrimin e vigjilencës së duhur ndaj klientit

Neni 21

Kur një subjekt raportues nuk është në gjendje të përmbushë kërkesën për zbatimin e masave të vigjilencës së duhur ndaj klientit (...) ai duhet të heqë dorë nga kryerja e transaksionit ose nga vendosja e marrëdhënies së biznesit, ta ndërpresë marrëdhënien e biznesit dhe të **marrë në konsideratë raportimin te NJIF-i të një transaksioni** të dyshimtë lidhur me klientin.

Kjo dispozitë e konsideron pamundësinë e ushtrimit të vigjilencës së duhur nga ana e linjave të mbrojtjes si një sinjal parësor informacioni të specializuar. Ajo kërkon që, nëse një subjekt nuk mund të verifikojë se kush është klienti ose çfarë veprimtarie kryen ai, jo vetëm të mos vazhdojë marrëdhënien e biznesit, por edhe të vlerësojë nëse kjo mungesë transparence përbën një dyshim që duhet të raportohet te NJIF-i, duke e kthyer kështu një dështim të përputhshmërisë në burim informacioni të specializuar për Njësinë e Inteligjencës Financiare.

<p>Fusha e zbatimit të masave të vigjilencës së zgjeruar Neni 34</p>	<p>Nëse NJIF-i identifikon kërcënime specifike ose modele të përsëritura të dyshimta dhe lëshon një njoftim formal, subjektet raportuese janë ligjërisht të detyruara ta integrojnë këtë informacion në vlerësimet e tyre të riskut. Ky njoftim shërben si tregues i detyrueshëm i riskut më të lartë, duke e detyruar subjektin të zbatojë masa të vigjilencës së zgjeruar për të menaxhuar dhe ulur risqet e identifikuar në mënyrë specifike nga autoritetet kombëtare.</p>
<p>3) (...) subjektet raportuese duhet të marrin në konsideratë (...) çdo tregues shtesë të një risku potencial më të lartë, siç janë njoftimet e lëshuara nga NJIF-i.</p>	
<p>Detyrimet e raportimit Kreu V</p>	<p>Kreu V përcakton detyrimet e raportimit që lidhen me NJIF-in.</p>
<p>Neni 69</p> <p>1) Subjektet raportuese (...) duhet të bashkëpunojnë plotësisht me NJIF-in duke:</p> <p>(a) raportuar menjëherë te NJIF-i (...) dhe duke iu përgjigjur kërkesave të NJIF-it për informacion shtesë (...).</p> <p>(b) (...) Në rast se gjykohet me rëndësi, NJIF-i mund ta shkurtojë afatin e kthimit të përgjigjes (...) në më pak se 24 orë.</p> <p>Neni 70</p> <p>1) (...) Organi vetërregullues i caktuar⁶ ia përcjell menjëherë dhe pa filtër informacionin e përmendur NJIF-it (...).</p>	<p>Neni 69 përfaqëson mandatin qendror të punës së NJIF-it duke kërkuar transmetimin e menjëhershëm të inteligjencës financiare nga sektori privat te ai shtetëror. Ai vendos një rregull raportimi “pa prag minimal”, që do të thotë se një dyshim duhet të raportohet pavarësisht vlerës monetare ose shumës së përfshirë; nuk ekziston asnjë kufi minimal financiar që duhet të arrihet përpara se një subjekt të detyrohet të njoftojë NJIF-in. Përveç raportit financiar, NJIF-it i jepen të drejta të shtuara për të kërkuar të dhëna plotësuese, përfshirë regjistrat e transaksioneve, brenda afateve strikte.</p> <p>Neni 70 siguron që NJIF-i të marrë ende të dhëna “të pafiltruara” edhe kur raportimi kryhet përmes një organi profesional për sektorë të vecantë dhe delikatë.</p>

⁶ Konkretisht, neni 70(1) i referohet subjekteve të nenit 3(3)(a) dhe (b), pra kryesisht **audituesve, kontabilistëve të jashtëm, këshilltarëve tatimorë, noterëve, avokatëve dhe profesionistëve të tjerë të pavarur të fushës juridike** për të cilët disa shtete anëtare lejojnë që disa kategori subjektësh raportuese të mos e dërgojnë informacionin e dyshimtë direkt te NJIF-i, por fillimisht te organi i tyre vetërregullues. Më pas, **organi vetërregullues i caktuar duhet ta përcjellë atë informacion** te NJIF-i menjëherë dhe pa e filtruar.

<p>Heqja dorë nga kryerja e transaksioneve Neni 71</p>	<p>Subjektet raportuese duhet të raportojnë transaksionet e dyshimta, duke i lënë NJIF-it një periudhë shqyrtimi prej tre ditësh, përveç rasteve kur ekzekutimi i menjëhershëm është i nevojshëm për të shmangur “sinjalizimin” e personit të dyshuar.</p>
<p>1) Subjektet raportuese duhet të heqin dorë nga kryerja e transaksioneve (...) derisa të kenë raportuar rastin e dyshimtë dhe (...) të kenë respektuar çdo udhëzim tjetër specifik nga NJIF-i.</p>	
<p>Dhënia e informacionit te NJIF-i Neni 72</p>	<p>Ky nen vendos një përgjegjësi për ata që raportojnë te NJIF-i, duke u siguruar që individët dhe institucionet të përmbushin detyrimet e tyre të raportimit pa frikë ose pasoja ligjore.</p>
<p>Dhënia e informacionit te NJIF-i në mirëbesim (...) nuk duhet të sjellë asnjë lloj përgjegjësi për subjektin raportues.</p>	
<p>Raportimi i transaksioneve mbi prag, të disa mallrave me vlerë të lartë Neni 74</p>	<p>Kjo dispozitë vendos detyrimin e raportimit te NJIF-i për personat që tregtojnë mallra me vlerë të lartë, institucionet e kreditit dhe institucionet financiare, brenda afateve të përcaktuara prej saj.</p>
<p>1) Personat që tregtojnë mallra me vlerë të lartë duhet të raportojnë te NJIF-i të gjitha transaksionet që përfshijnë shitjen e [automjeteve motorike, mjeteve lundruese dhe mjeteve ajrore] (...). 3) Raportimi (...) duhet të kryhet brenda afateve të vendosura nga NJIF-i.</p>	

**Shkëmbimi i informacionit në kuadër të partneriteteve
për ndarjen e informacionit**
Neni 75

1) Subjektet raportuese që synojnë të marrin pjesë në një partneritet për ndarjen e informacionit duhet të njoftojnë autoritetet e tyre mbikëqyrëse përkatëse (...). Kur është e **nevojshme, autoriteti mbikëqyrës konsulton edhe NJIF-in.**

(...) 4) (k) **ndarja e informacionit mbi** transaksionet e dyshimta (...) **duhet të kryhet vetëm kur NJIF-i të cilit i është paraqitur raporti i transaksionit të dyshimtë (...) është** pajtuar me këtë ndarje informacioni.

5) Informacioni i marrë në kuadër të një partneriteti për ndarjen e informacionit nuk mund të transmetohet më tej, përveç kur:

(b) **informacioni duhet të përfshihet në një raport të paraqitur te NJIF-i ose të jepet në përgjigje të një kërkesë të NJIF-it (...).**

Kjo dispozitë siguron që, ndonëse informacioni mund të qarkullojë ndërmjet subjekteve private për të luftuar krimin financiar, NJIF-i mbetet autoriteti përgjegjës për administrimin e këtij informacioni.

<p>Mbrojtja e të dhënave dhe ruajtja e evidencave Kreu VII</p>	<p>Këto nene përqendrohen te nevoja e NJIF-it për <i>inteligjencë retrospektive</i>. Neni 77 kërkon që subjektet të ruajnë për 5 vjet prova fizike ose digjitale të ndërveprimit me NJIF-in, ndërsa neni 78 e plotëson këtë kërkesë duke i detyruar subjektet të mbajnë sisteme teknike që i mundësojnë NJIF-it të rindërtojë në mënyrë të plotë dhe të shpejtë gjurmën financiare të një të dyshuari në institucione të ndryshme.</p>
<p>Neni 77</p> <p>1) Subjektet raportuese duhet të ruajnë dokumentet dhe informacionin e mëposhtëm:</p> <p>(b) një evidencë të vlerësimit të kryer (...), përfshirë informacionin dhe rrethanat e marra në konsideratë dhe rezultatet e këtij vlerësimi, pavarësisht nëse ky vlerësim ka rezultuar ose jo në raportimin e një transaksioni të dyshimtë te NJIF-i.</p> <p>Neni 78</p> <p>Subjektet raportuese duhet të kenë sisteme që u mundësojnë t'u përgjigjen plotësisht dhe shpejt kërkesave të NJIF-it.</p>	<p>Ky nen u kërkon bankave të raportojnë lëvizjet në <i>cash</i> me vlerë të lartë, në mënyrë që NJIF-i të analizojë burimin dhe modelet e qarkullimit të parasë fizike, pavarësisht mungesës së një dyshimi fillestar.</p>
<p>Kufizimet për pagesat e mëdha në cash kundrejt mallrave ose shërbimeve Neni 80</p>	
<p>4) (...) Pagesat ose depozitat në cash (...) mbi pragun e përcaktuar duhet të raportohen te NJIF-i brenda afateve të përcaktuara.</p>	

Bashkëpunimi ndërmjet NJIF-it dhe EPPO-së
Seksioni 1

Neni 81

Çdo NJIF i raporton EPPO-së pa vonesë rezultatet e analizave të saj dhe çdo informacion shtesë përkatës kur ka arsye të arsyeshme për të dyshuar për pastrim parash ose veprimtari të tjera kriminale (...) për të cilat EPPO-ja mund të ushtrojë kompetencën e saj.

Neni 82

NJIF-i dhe EPPO-ja mund të shkëmbejnë rezultatet e analizave strategjike përkatëse.

Këto nene krijojnë një urë të ndërsjellë informacioni të specializuar ndërmjet NJIF-it dhe EPPO-së. Ato sigurojnë që analizat financiare të NJIF-it të mbështesin ndjekjet penale në nivel të BE-së për vepra si mashtrimi ose korrupsioni, ndërkohë që i mundësojnë NJIF-it të marrë informacion hetimor nga EPPO-ja për të forcuar analizat e veta kombëtare.

Bashkëpunimi ndërmjet NJIF-it dhe OLAF-it
Seksioni 2

Neni 83

1) (...) **Çdo NJIF duhet të përcjellë pa vonesë rezultatet e analizave të tij tek OLAF-i** (...) kur ka arsye të arsyeshme për të dyshuar për mashtrim, korrupsion ose çdo veprimtari tjetër të paligjshme që prek interesat financiare të Bashkimit European(...), për të cilat OLAF-i mund të ushtrojë kompetencën e vet (...).

NJIF-et dhe OLAF-i mund të shkëmbejnë rezultatet përkatëse të analizave strategjike.

Neni 84

OLAF-i duhet t'i përgjigjet në kohë kërkesave për informacion të një NJIF-i.

Ngjashëm me EPPO-në, këto dispozita krijojnë një linjë të drejtpërdrejtë komunikimi ndërmjet NJIF-eve dhe OLAF-it.

Raportet
Neni 88

(...) Komisioni duhet të paraqesë raporte (...) duke vlerësuar nevojën dhe proporcionalitetin e (...) vendosjes së një **formati të harmonizuar për raportimin e transaksioneve, duke konsideruar që këto raporte të jenë të dobishme për NJIF-in.**

Komisioni duhet të verifikojë nëse "raportet automatike mbi një vlerë të caktuar" të gjeneruara nga sektori privat po u ofrojnë realisht informacion të dobishëm NJIF-eve në misionin e tyre për të zbuluar dhe luftuar pastrimin e parave.

DIREKTIVA E GJASHTË E AML-SË

TEKSTI LEGJISLATIV

Direktiva(BE)2024/1640 e Parlamentit European dhe e Këshillit, datë 31 maj 2024, mbi mekanizmat që duhet të vendosen nga Shtetet Anëtare për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit – AMLD6.

DISPOZITAT	SHPJEGIMI
<p>Krijimi i Njësive të Inteligjencës Financiare Neni 19</p> <p>1) Shtetet Anëtare duhet të krijojnë një <i>Njësi të Inteligjencës Financiare</i> për të parandaluar, zbuluar dhe luftuar në mënyrë efektive pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit (...)</p> <p>2) NJIF-i është njësia e vetme qendrore kombëtare përgjegjëse për marrjen dhe analizimin e raporteve të dyshimta të paraqitura nga subjektet raportuese (...).</p> <p>3) NJIF-i është autoriteti përgjegjës për shpërndarjen e rezultateve të analizave të saj dhe të çdo informacioni shtesë tek autoritetet kompetente përkatëse kur ekzistojnë arsye për të dyshuar për pastrim parash, veprat penale bazë ose financim të terrorizmit. Ai duhet të jetë në gjendje të marrë informacion shtesë nga subjektet raportuese.</p> <p>4) Çdo NJIF duhet të jetë operacionalisht i pavarur dhe autonom, çka do të thotë se duhet të ketë autoritetin dhe kapacitetin për të ushtruar lirisht funksionet e saj, përfshirë aftësinë për të marrë vendime autonome për të analizuar, kërkuar dhe (...), shpërndarë informacion specifik. Ai duhet të jetë i lirë nga çdo ndikim ose ndërhyrje e papërshtatshme politike, qeveritare ose e industrisë.</p>	<p>Ky nen e vendos NJIF-in si qendrën kombëtare të inteligjencës financiare, duke centralizuar raportet nga subjektet raportuese, autoritetet doganore dhe mbikëqyrësit. Për të garantuar integritetin e hetimeve, NJIF-i duhet të ketë kapacitetin për të marrë vendime autonome lidhur me analizën dhe shpërndarjen e informacionit. Edhe kur NJIF-i është pjesë e strukturës së një autoriteti tjetër (si Ministria e Financave ose Policia), funksionet e tij thelbësore duhet të ndahen operacionalisht nga funksionet e tjera të atij organi pritës.</p> <p>Mandati i NJIF-it ndahet në dy linja të dallueshme analitike:</p> <ul style="list-style-type: none">- Analiza operationale, e cila përqendrohet në raste individuale dhe objektiva specifike- Analiza strategjike, e cila identifikon prirje dhe modele më të gjera të pastrimit të parave/financimit të terrorizmit. <p>Shtetet Anëtare janë ligjërisht të detyruara të sigurojnë burime të mjaftueshme për t'i mundësuar NJIF-it të përdorë burimet e tij në mënyrë të pavarur. Personeli duhet t'i përmbahet standardeve të larta profesionale, përfshirë trajtimin etik të grupeve të mëdha të të dhënave dhe procedurat strikte për menaxhimin e konflikteve të interesit. Për më tepër, NJIF-i duhet të caktojë një Zyrtar për të Drejtat Themelore (shih nenin 20 mbi Zyrtarin për të Drejtat Themelore).</p>

AMLD5⁷ kundrejt AMLD6

Krahasuar me AMLD5, AMLD6 ofron garanci më të forta ligjore për integritetin e NJIF-eve duke përcaktuar shprehimisht pavarësinë dhe autonominë e tyre operacionale.

Praktika të mira

Në disa vende, NJIF-et janë të integruara drejtpërdrejt në autoritetet kombëtare të zbatimit të ligjit, gjë që e bën bashkëpunimin më të natyrshëm. Në Portugali dhe Lituani, NJIF-i është i vendosur pranë policisë financiare gjyqësore, një strukturë që hetuesit e konsiderojnë si avantazh të madh për shndërrimin e *informacionit të specializuar* në çështje aktive. Po kështu, Italia shfrytëzon sinergji të forta institucionale dhe policinë financiare të specializuar për të siguruar që raportet e transaksioneve të dyshimta të çojnë në ndjekje penale efektive. Këto vende minimizojnë vonesat e koordinimit dhe bëjnë të mundur që të dhënat financiare me vlerë të lartë të kenë përparësi në hetim.

⁷ AMLD5 - Akronim për *The fifth Anti-Money Laundering Directive*

Aksesi në informacion

Neni 21

1) Shtetet Anëtare duhet të garantojnë që NJIF-et (...) të kenë akses në informacionin që u nevojitet për përmbushjen e detyrave të tyre, përfshirë informacion financiar, administrativ dhe nga agjencitë e zbatimit të ligjit (...) [duke përfshirë] të paktën:

(a) akses të menjëhershëm dhe të drejtpërdrejtë në (...) informacion financiar (...); [dhe]

(b) akses të menjëhershëm dhe të drejtpërdrejtë në (...) informacion administrativ (...).

NJIF-eve u jepet akses i drejtpërdrejtë në një gamë të gjerë të dhënash, përfshirë regjistrat e llogarive bankare (shih nenin 16 të AMLD6), të dhënat tatimore, të dhënat doganore dhe bazat e të dhënave të zbatimit të ligjit. **Aksesi konsiderohet “i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm” kur merret përmes mekanizmave të automatizuar** pa ndërmjetës. Ky akses gjithëpërfshirës synon t’u mundësojë NJIF-eve të hartëzojnë në mënyrë efektive rrjetet kriminale të ndërlikuara pa u penguar nga përfshirja e autoriteteve të tjera.

AMLD5 kundrejt AMLD6

AMLD6 i eliminon mospërputhjet kombëtare dhe garanton që NJIF-et në të gjithë BE-në të kenë të njëjtat mjete analitike. Në AMLD5, listat specifike të të dhënave të aksesueshme nuk ishin harmonizuar plotësisht.

Përgjigjet ndaj kërkesave për informacion

Neni 22

1) **Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që NJIF-et të jenë në gjendje t'u përgjigjen** në kohë kërkesave të arsyetuara për informacion (...) nga autoritetet kompetente (...) në Shtetet e tyre Anëtare përkatëse, kur ky informacion mbahet tashmë nga NJIF-i dhe është i nevojshëm **rast pas rasti. Vendimi për kryerjen e shpërndarjes së informacionit mbetet në kompetencën e NJIF-it.**

Kur ka arsye objektive për të supozuar se dhënia e një informacioni të tillë do të kishte ndikim negativ mbi hetimet ose analizat në vijim (...), **NJIF-i nuk është i detyruar të përmbushë kërkesën për informacion.** Në raste të tilla, **NJIF-i ia jep** me shkrim arsyet autoritetit kërkues.

2) **Autoritetet kompetente japin mendim (...) për t'i mundësuar NJIF-it të përmirësojë funksionin e tij të analizës operacionale.**

Ky nen e vendos NJIF-in si një qendër informacioni për autoritetet e tjera kompetente të brendshme (si autoritetet e zbatimit të ligjit dhe autoritetet tatimore). Ai siguron që informacioni i mbajtur tashmë nga NJIF-i mund të ndahet për të mbështetur raste specifike, por në mënyrë thelbësore ruan autonominë operacionale të NJIF-it.

Për më tepër, ai vendos një marrëdhënie të ndërsjellë, sipas së cilës autoritetet përfituese duhet të raportojnë se si është përdorur informacioni i specializuar, duke krijuar një cikël shkëmbimi informacioni që përmirëson saktësinë analitike të ardhshme të NJIF-it.

AMLD5 kundrejt AMLD6

AMLD6 vendos kërkesa më të strukturuar për bashkëpunimin e brendshëm. Ndryshe nga AMLD5, ajo u kërkon shprehimisht autoriteteve përfituese të japin mendim të NJIF-i për të përmirësuar analizën e saj operacionale në të ardhmen.

Dhënia e informacionit për mbikëqyrësit

Neni 23

1) (...) **NJIF-i u jep mbikëqyrësve**, në mënyrë spontane ose me kërkesë, informacion që mund të jetë i rëndësishëm për qëllime mbikëqyrjeje (...), përfshirë (...)

(a) **cilësinë dhe sasinë e raporteve të transaksioneve të dyshimta** të paraqitura nga subjektet raportuese;

(b) **cilësinë dhe afatet e përgjigjeve të dhëna** ndaj kërkesave të NJIF-it (...);

(c) rezultatet **përkatese të analizave strategjike**.

Që mbikëqyrja e bazuar në risk të jetë efektive, mbikëqyrësit duhet të dinë se cilat subjekte raportuese (p.sh. bankat) po dështojnë në përmbushjen e detyrave të tyre. Ky nen i kërkon NJIF-it të ndajë informacion mbi performancën raportuese të këtyre subjekteve.

AMLD5 kundrejt AMLD6

AMLD6 e përmirëson ndjeshëm mbikëqyrjen duke zëvendësuar bashkëpunimin e përgjithshëm të AMLD5 me një listë të detyrueshme dhe shteruese të të dhënave mbi performancën që NJIF-i duhet të ndajë me mbikëqyrësit.

Pezullimi ose mosdhënia e pëlqimit

Neni 24

1) Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që **NJIF-et të kenë kompetencën për të ndërmarrë veprime urgjente (...) për të pezulluar ose për të mos dhënë pëlqim për një transaksion**. (...) Shtetet Anëtare përcaktojnë periudhën e pezullimit (...), e cila nuk duhet të kalojë 10 ditë pune. (...) NJIF-i duhet të ketë kompetencën të ndërmarrë veprime urgjente (...) **për të pezulluar përdorimin e një llogarie (...)**, për një periudhë që nuk duhet të kalojë 5 ditë pune.

Këto kompetenca parandaluese i mundësojnë NJIF-it të bllokojë fondet kriminale përpara se ato të zhvendosen ose të fshihen. Meqenëse kjo prek të drejtat pronësore, neni vendos afate strikte për të garantuar që masa të jetë proporcionalisht e justifikuar nga pikëpamja ligjore, duke i lejuar njëkohësisht NJIF-it të konfirmojë dyshimet dhe ta referojë çështjen për sekuestrim.

AMLD5 kundrejt AMLD6

AMLD6 e përmirëson kuadrin rregullator duke harmonizuar afatet maksimale të pezullimit në të gjithë BE-në, duke eliminuar mospërputhjet kombëtare që ekzistonin sipas AMLD5.

<p>Udhëzime për monitorimin e transaksioneve ose aktiviteteve Neni 25</p>	
<p>Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që NJIF-et të kenë kompetencën t'u japin udhëzime subjekteve raportuese të monitorojnë (...) transaksionet ose aktivitetet (...) për persona që paraqesin risk të konsiderueshëm lidhur me pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit.</p>	<p>Kjo dispozitë e vendos NJIF-in në një rol hetimor proaktiv, duke i dhënë atij njohuri shtesë mbi sjelljen financiare të një subjekti me risk të lartë në kohë. Monitorimi në kohë reale ndihmon në zbulimin e modeleve të sofistikuara që mund të mos kapen nga një raport i vetëm, duke siguruar analizë më efektive dhe pezullim të mundshëm të llogarisë.</p>
<p>Njoftime për subjektet raportuese Neni 26</p>	
<p>Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që NJIF-et të jenë në gjendje të njoftojnë subjektet raportuese për informacione të rëndësishme lidhur me ushtrimin e vigjilencës së duhur ndaj klientit (...)</p> <p>(a) lloje transaksionesh (...) që paraqesin risk të konsiderueshëm;</p> <p>(b) persona specifike (...);</p> <p>(c) zona gjeografike specifike.</p>	<p>NJIF-i i ofron sektorit privat informacion shumë të vlefshëm për të përmirësuar procedurat e tyre të vigjilencës së duhur ndaj klientit. Duke njoftuar subjektet për persona ose zona specifike me risk të lartë, NJIF-i siguron që "linjat e mbrojtjes" të subjekteve raportuese të jenë të informuara për kërcënimet në zhvillim dhe të mund të përshtatin sistemet e tyre të menaxhimit të riskut.</p>
<p>Raporti vjetor i NJIF-it Neni 27</p>	
<p>Çdo Shtet Anëtar duhet të sigurohet që NJIF-i i tij të publikojë një raport vjetor për veprimtarinë e tij.</p>	<p>//</p>

<p>Kthimet e përgjigjeve nga NJIF-i Neni 28</p>	<p>Kthimi i përgjigjeve është mjeti kryesor për kontrollin e cilësisë, duke e ndihmuar sektorin privat të përmirësojë aftësinë për të zbuluar dhe raportuar veprimtari të dyshimta. Duke vlerësuar cilësinë dhe kohën e raporteve, NJIF-i sigurohet që informacionet që vijnë në përmjet raportimeve të jenë të përdorshme në praktikë.</p>
<p>1) Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që NJIF-et t'u kthejnë përgjigje subjekteve raportuese mbi raportimin e rasteve të dyshimta (...). Kjo përgjigje duhet të mbulojë të paktën cilësinë e informacionit të dhënë dhe kohën e raportimit (...). NJIF-i duhet të japë përgjigje të paktën një herë në vit. (...)</p> <p>NJIF-et duhet të raportojnë çdo vit pranë AMLA-s lidhur me kthimet e përgjigjeve ndaj subjekteve raportuese (...). Deri më 10 korrik 2028, AMLA duhet të nxjerrë rekomandime për NJIF-et mbi praktikat dhe qasjet më të mira lidhur me kthimet e përgjigjeve.</p> <p>2) Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që NJIF-et t'u kthejnë përgjigje autoriteteve doganore.</p>	<p>AMLD5 kundrejt AMLD6</p> <p>AMLD6 e përmirëson mekanizmin e raportimit duke e bërë kthimin e përgjigjes kërkesë ligjore të detyrueshme, që duhet të jepet të paktën një herë në vit, ndërsa AMLD5 e kërkonte vetëm "nëse ishte e disponueshme".</p>
<p>Bashkëpunimi ndërmjet NJIF-eve Neni 29</p> <p>Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që NJIF-et të bashkëpunojnë sa më shumë të jetë e mundur, pavarësisht statusit të tyre organizativ.</p>	<p>Meqenëse paratë e paligjshme janë shpesh ndërkufitare, pengesat kombëtare nuk duhet të cenojnë aftësinë për të zhvilluar analiza parandaluese. Ky nen siguron që, pavarësisht nëse një njësi intelligence financiare është me natyrë administrative, gjyqësore ose e lidhur me agjencitë e zbatimit të ligjit, ajo është ligjërish e detyruar t'u japë ndihmë njësive homologe. Ky nen e trajton Bashkimin Europian si një zonë të vetme intelligence, dhe jo si një bashkësi sistemesh të veçanta kombëtare.</p>

Kanale të mbrojtura komunikimi

Neni 30

Duhet të krijohet një sistem për shkëmbimin e informacionit ndërmjet **NJIF-eve të Shteteve Anëtare (FIU.net)**.

FIU.net duhet të sigurojë komunikim dhe shkëmbim të sigurt informacioni (...) [dhe] **do të administrohet nga AMLA**.

Infrastruktura e sigurt është parakusht për krijimin e besimit. Direktiva e formalizon *FIU.net* si **sistemin e enkriptuar për bashkëpunimin ndërkufitar, i administruar nga AMLA**, për të garantuar standarde të larta teknologjike dhe mbrojtje të njëtrajtshme të të dhënave.

Platforma u mundëson NJIF-eve të kryejnë krahasime të të dhënave të tyre me të dhënat e njërive të tjera, në mënyrë që fillimisht të përcaktohet vetëm nëse ekziston ose jo një përputhje, pa u zbuluar menjëherë informacioni konfidencial. Vetëm kur konstatohet një përputhje, vijon shkëmbimi i informacionit përkatës. Kjo qasje shërben për të lehtësuar bashkëpunimin ndërmjet NJIF-eve, duke garantuar mbrojtjen e të dhënave dhe duke shmangur përpunimin e panevojshëm të informacionit personal. Ky mekanizëm njihet si "hit/no-hit".

AMLD5 kundrejt AMLD6

AMLD6 e formalizon FIU.net dhe menaxhimin e tij të centralizuar nga AMLA, duke ofruar stabilitet më të madh teknik dhe funksionalitete të avancuara si mekanizmi **hit/no-hit**.

Shkëmbimi i informacionit ndërmjet NJIF-ve

Neni 31

1) Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që NJIF-et **të shkëmbejnë (...) çdo informacion që mund të jetë i rëndësishëm (...)**, pavarësisht nga lloji i veprave penale të origjinës që mund të jenë të përfshira, madje edhe nëse ato nuk janë identifikuar në momentin e shkëmbimit.

Shpejtësia është thelbësore në luftën kundër pastrimit të parave. Ky nen vendos **afate të rrepta për përgjigjet** (zakonisht 5 ditë pune, ose 1 ditë pune në raste urgjente) për të përmbushur kufizimet procedurale të hetimeve. Ai garanton që informacioni të qarkullojë lirshëm edhe kur vepra konkrete bazë (p.sh. mashtrimi ose trafikimi i drogës) ende nuk është provuar, dhe u kërkon NJIF-eve të përdorin gamën e plotë të kompetencave të tyre kombëtare për të dhënë ndihmë.

AML5 kundrejt AML6

AML6 vendos afate për shkëmbimin e informacionit me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit ndërkufitar.

Praktika të mira

AMLA do ta lehtësojë punën e NJIF-eve duke ofruar shërbime të avancuara IT-je dhe inteligjence artificiale, të cilat rrisin ndjeshëm kapacitetet e tyre për analizimin e të dhënave dhe zbulimin e rasteve të dyshimta. Kjo arrihet duke ofruar një qendër të sigurt dhe të centralizuar për shkëmbimin e informacionit dhe duke koordinuar analizat e përbashkëta.

<p>Analiza të përbashkëta Neni 32</p>	<p>NJIF-et kanë kompetencë të kryejnë analiza operacionale të integruara përmes ekipeve të përbashkëta, të mbështetura nga AMLA. Këto ekipe bashkojnë burimet dhe informacionin për të siguruar një pamje të plotë të veprimtarive anormale ndërkufitare, të cilën një autoritet i vetëm kombëtar nuk do të mund ta shihte i vetëm.</p>
<p>1) Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që NJIF-et e tyre të jenë në gjendje të kryejnë analiza të përbashkëta (...) [dhe]</p> <p>2) të krijojnë një ekip të analizës së përbashkët për një qëllim specifik dhe për një periudhë të kufizuar.</p>	<p>Praktika të mira</p> <p>Në vitin 2023, NJIF-et franceze dhe luksemburgase demonstuan një analizë të përbashkët të suksesshme për të shkatërruar një rrjet ndërkombëtar mashtrimi me TVSH. Duke shkuar përtej shkëmbimit tradicional të informacionit mbi bazën e kërkesave, të dyja NJIF-et krahasuan grupe të gjera të dhënash (përfshirë regjistra bankarë dhe të dhëna tatimore) përmes kanaleve të sigurta (p.sh. FIU.net), me qëllim hartëzimin e një rrjeti të ndërlikuar shoqërisht guaskë dhe fluksesh financiare, i cili do të kishte mbetur i padukshëm për një juridiksion të vetëm. Kjo sinergji u mundësoi krijimin e një pamjeje gjithëpërfshirëse të infrastrukturës kriminale, duke çuar në referimin e drejtpërdrejtë të çështjes te Zyra e Prokurorit Publik Europian (EPPO).</p>
<p>Përdorimi nga NJIF-et i informacionit të shkëmbyer ndërmjet tyre Neni 33</p>	<p>Të dhënat e marra nga NJIF-et e tjera duhet të përdoren rreptësisht për detyrat e përcaktuara me ligj. Për të ruajtur besimin reciprok, njëzia transmetuese ka të drejtë të vendosë kushte specifike për të siguruar që informacioni i shkëmbyer të përdoret vetëm për qëllimet për të cilat është dhënë.</p>
<p>Informacioni dhe dokumentet e marra (...) përdoren për përmbushjen e detyrave të NJIF-it (...); NJIF-i që transmeton të dhëna mund të vendosë kufizime dhe kushte lidhur me përdorimin e këtyre të dhënave.</p>	

<p>Pëlqimi për shpërndarjen e mëtejshme të informacionit të shkëmbyer ndërmjet NJIF-eve Neni 34</p>	<p>NJIF-i përfitues duhet të marrë leje nga njësia fillestare dhënëse përpara se të ndajë të dhënat me një autoritet tjetër (si p.sh. policia). Pëlqimi duhet të jepet menjëherë dhe, në raste të jashtëzakonshme, sa më shumë të jetë e mundur.</p>
<p>1) (...) Shpërndarja e informacionit të shkëmbyer nga NJIF-i përfitues te çdo autoritet tjetër (...) i nënshtrohet pëlqimit paraprak të NJIF-it që e ka dhënë informacionin.</p>	
<p>Efekti i dispozitave të së drejtës penale Neni 35</p>	<p>Mospërputhjet ligjore ndërmjet Shteteve Anëtare lidhur me përkufizimin e veprave penale bazë nuk duhet të përdoren për të penguar dhënien e ndihmës. NJIF-i nuk mund të refuzojë bashkëpunimin thjesht sepse përkufizimi i tij kombëtar për një vepër penale ndryshon nga ai i vendit kërkues. Kjo siguron një front të harmonizuar mbrojtës në të gjithë tregun e brendshëm.</p>
<p>Dallimet ndërmjet përkufizimeve në të drejtën kombëtare të veprave penale bazë nuk pengojnë aftësinë e NJIF-eve për t'i dhënë ndihmë një NJIF-i tjetër dhe nuk kufizojnë shkëmbimin, shpërndarjen dhe përdorimin e informacionit.</p>	
<p>Konfidencialiteti i raportimit Neni 36</p>	<p>Shtetet Anëtare duhet të mbrojnë identitetin e “linjave të mbrojtjes” (si punonjësit e bankave) që sinjalizojnë veprimtari të dyshimta. NJIF-eve u ndalohet të zbulojnë burimin e një raportimi kur u shpërndajnë gjetjet hetuesve, me qëllim parandalimin e hakmarrjes dhe garantimin e efektivitetit të mekanizmit të raportimit.</p>
<p>1) Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që NJIF-et të kenë mekanizma për mbrojtjen e identitetit të subjekteve raportuese dhe punonjësve të tyre (...) që raportojnë raste të dyshimta (...)</p>	<p>AMLD5 kundrejt AMLD6</p>
<p>2) NJIF-et nuk duhet të zbulojnë burimin e raportimit.</p>	<p>AMLD6 shton një shtresë mbrojtjeje për “linjat e mbrojtjes”, duke siguruar që identiteti i tyre të mbrohet gjatë fazës hetimore.</p>

TEKSTI LEGJISLATIV

Rregullorja(BE) 2024/1620 e Parlamentit European dhe e Këshillit, datë 31 maj 2024, për krijimin e Autoritetit për Luftën kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit dhe për ndryshimin e Rregullores (BE) nr. 1094/2010 dhe (BE) nr. 1095/2010.

DISPOZITAT	SHPJEGIMI
Krijimi dhe fusha e veprimit Neni 1	
<p>1) Krijohet Autoriteti për Luftën kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit ("Autoriteti").</p> <p>(...)</p> <p>3) Qëllimi i Autoritetit është të mbrojë interesin publik, stabilitetin dhe integritetin e sistemit financiar të Bashkimit European, si dhe funksionimin e rregullt të tregut të brendshëm, duke (...):</p> <p>(a) parandaluar përdorimin e sistemit financiar të Bashkimit për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;</p> <p>(b) kontribuar në identifikimin dhe vlerësimin e risqeve dhe kërcënimeve të Aml/CFT në të gjithë tregun e brendshëm;</p> <p>(c) siguruar mbikëqyrje me cilësi të lartë në fushën e (...) AML/CFT në të gjithë tregun e brendshëm;</p> <p>(e) kontribuar në harmonizimin e praktikave për zbulimin e transaksioneve ose aktiviteteve të dyshimta nga NJIF-et;</p> <p>(f) mbështetur dhe koordinuar shkëmbimin ndërmjet NJIF-eve, si dhe ndërmjet NJIF-ve dhe autoriteteve të tjera kompetente.</p>	<p>AMLA është një agjenci e Bashkimit European me natyrë juridike, e krijuar për të shërbyer si shtylla qendrore e një sistemi të integruar mbikëqyrës dhe inteligjence AML/CFT në mbarë BE-në. Selia e saj ndodhet në Frankfurt, Gjermani.</p> <p>Objektivat kryesore të AMLA-s janë të kapërcejë zbatimin e fragmentuar kombëtar të paketës AML për të garantuar funksionimin e rregullt të tregut të brendshëm. Mandati i saj përfshin identifikimin e kërcënimeve të jashtme dhe të brendshme, krijimin e një metodologjie të harmonizuar mbikëqyrëse dhe veprimin si mekanizëm mbështetjeje e koordinimi për NJIF-et kombëtare, me qëllim garantimin e zbulimit të njëtrajtshëm të veprimtarive të dyshimta.</p> <p>Megjithëse Rregullorja AMLA hyri në fuqi në vitin 2024, shumica e dispozitave të saj u bënë të zbatueshme nga 1 korriku 2025, ndërsa nenet themelore nisën të zbatoheshin nga 26 qershori 2024 për të mundësuar krijimin fillestar të Autoritetit. Komisioni mbeti përgjegjës për operacionet fillestare të Autoritetit deri më 31 dhjetor 2025. AMLA pritet të fillojë veprimtarinë e saj të plotë në fillim të vitit 2027.</p>

Detyrat

Neni 5

- 5) Autoriteti kryen detyrat e mëposhtme në lidhje me NJIF-et (...):
- (a) mban një listë të përditësuar të NJIF-eve brenda Bashkimit;
 - (b) **monitoron ndryshimet në kuadrin ligjor të NJIF-eve, si dhe në organizimin e tyre, (...)**
 - (c) **mbështet punën e NJIF-eve** dhe kontribuon në përmirësimin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet tyre;
 - (d) **kontribuon në identifikimin dhe përzgjedhjen e rasteve përkatëse për kryerjen e analizave të përbashkëta nga NJIF-et;**
 - (e) zhvillon metoda dhe procedura të përshtatshme për kryerjen e analizave të përbashkëta nga NJIF-et për rastet ndërkufitare;
 - (f) **krijon, koordinon, organizon dhe lehtëson kryerjen e analizave të përbashkëta** të kryera nga NJIF-et;
 - (g) ofron asistencë për NJIF-et, (...)
 - (h) **kryen vlerësime ndërmjet kolegëve** për veprimtarinë e NJIF-eve (...)
 - (i) **zhvillon dhe u vë në dispozicion NJIF-eve mjete** dhe shërbime për të rritur kapacitetet e tyre analitike (...)
 - (j) **zhvillon, ndan dhe promovon njohuri të specializuara** mbi metodat e zbulimit, analizës dhe shpërndarjes së transaksioneve të dyshimta;
 - (k) me kërkesë të NJIF-eve, u ofron atyre trajnim dhe **asistencë të specializuar, (...)**
 - (l) mbështet, me kërkesë të NJIF-eve, ndërveprimin e tyre me subjektet raportuese duke u ofruar këtyre subjekteve njohuri të specializuara;
 - (m) **përgatit dhe koordinon vlerësime dhe analiza strategjike të kërcënimeve, risqeve dhe metodave AML/CFT** të identifikuar nga NJIF-et.

Kjo dispozitë e vendos AMLA-n si qendrën kryesore operacionale dhe ofruesin e shërbimeve për rrjetin e NJIF-eve të Bashkimit European. Qëllimi i saj është të shkojë përtej bashkëpunimit jo efektiv për rastet ndërkufitare, duke krijuar një sistem të integruar që siguron bashkëpunim efektiv. AMLA ngarkohet të ofrojë bazën teknike të këtij sistemi duke administruar *FIU.net*, i cili lehtëson shkëmbimin e sigurt të informacionit dhe të të dhënave. Përtej mbështetjes teknike, AMLA merr një rol udhëheqës në analizat e përbashkëta, duke mundësuar koordinimin e drejtpërdrejtë të hetimeve për raste ndërkufitare që njësitë mund ta kenë të vështirë t'i trajtojnë të vetme. Detyra e kryerjes së analizave strategjike dhe vlerësimeve ndërmjet kolegëve, siguron harmonizimin e praktikave në zbulimin e transaksioneve të dyshimta. Kjo i mundëson AMLA-s të identifikojë risqet AML/CFT dhe të nxisë shkëmbimin e praktikave më të mira dhe veprimtarive trajnuese për të siguruar që të gjitha NJIF-et të funksionojnë vazhdimisht në një nivel të lartë cilësie.

<p>Kompetencat e Autoritetit Neni 6</p>	
<p>3) Në lidhje me NJIF-et në Shtetet Anëtare, Autoriteti ka kompetencat e mëposhtme:</p> <p>(a) të kërkojë të dhëna dhe analiza jo-operacionale (...) për vlerësimin e kërcënimeve (...);</p> <p>(b) të mbledhë informacion dhe statistika;</p> <p>(c) të marrë dhe përpunojë informacionin dhe të dhënat e nevojshme për fillimin, kryerjen dhe koordinimin e analizave të përbashkëta;</p> <p>(d) të nxjerrë udhëzime dhe rekomandime.</p>	<p>Këto kompetenca i mundësojnë AMLA-s të mbledhë të dhëna dhe statistika të nivelit të lartë, të nevojshme për identifikimin e risqeve në nivel të Bashkimit Europian, duke i dhënë njëkohësisht mjetet ligjore për të drejtuar dhe përpunuar të dhëna për hetime specifike bashkëpunuese.</p>
<p>Metodologjia mbikëqyrëse AML/CFT Neni 8</p> <p>4) (...) Autoriteti rishikon dhe përditëson periodikisht metodologjinë e tij mbikëqyrëse, duke marrë në konsideratë evolucionin e risqeve që prekin tregun e brendshëm, përfshirë risqet dhe kërcënimet e identifikuar nga autoritetet kombëtare të zbatimit të ligjit dhe NJIF-eve.</p>	<p>Kjo dispozitë krijon një cikël kritik shkëmbimi informacioni ndërmjet <i>inteligjencës</i> dhe mbikëqyrjes. Ajo kërkon që metodologjia e harmonizuar e përdorur për mbikëqyrjen e institucioneve financiare të ushqehet vazhdimisht me modelet reale kriminale, risqet dhe kërcënimet e zbuluara nga NJIF-et kombëtare dhe autoritetet e zbatimit të ligjit. Duke përfshirë këtë informacion, Rregullorja siguron që praktikat mbikëqyrëse të mbeten të bazuara në risk dhe të reagojnë ndaj metodave më të fundit të AML/CFT të identifikuar në terren.</p>
<p>Bashkëpunimi ndërmjet Autoritetit dhe NJIF-eve Neni 39</p> <p>1) Autoriteti është përgjegjës për sigurimin e bashkëpunimit efektiv dhe të njëtrajtshëm ndërmjet NJIF-eve në kuadër të mekanizmit të mbështetjes dhe koordinimit për NJIF-et. (...)</p> <p>2) Autoriteti dhe NJIF-et i nënshtrohen detyrimit për të bashkëpunuar në mirëbesim (...) si dhe detyrimit për të shkëmbyer informacionin e nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre përkatëse.</p> <p>3) (...) Një NJIF mund të informojë Autoritetin në rast se një NJIF tjetër dështon të bashkëpunojë. Në këtë rast, Autoriteti vepron si ndërmjetës.</p>	<p>Ky nen krijon një detyrim formal ligjor që NJIF-et kombëtare dhe AMLA të punojnë së bashku, duke vendosur një mekanizëm të strukturuar ku bashkëpunimi është detyrim i detyrueshëm dhe jo marrëveshje vullnetare.</p>

Kryerja e analizës së përbashkët

Neni 40

3) Kur (...) një NJIF i një Shteti Anëtar identifikon nevojën e mundshme për të kryer një analizë të përbashkët me një ose disa NJIF-e në Shtete të tjera Anëtare, ai njofton Autoritetin për këtë. (...) Kur Autoriteti **vlerëson se çështja** është e rëndësishme, ai, brenda **pesë ditëve nga** njoftimi fillestar, informon NJIF-et në të gjitha **Shtetet Anëtare** përkatëse dhe i fton të marrin pjesë në analizën e përbashkët. (...) NJIF-et në të gjitha **Shtetet Anëtare** përkatëse **duhet të marrin në konsideratë pjesëmarrjen** në analizën e përbashkët.

4) Nëse të paktën një NJIF tjetër pranon të marrë pjesë në analizën e përbashkët, Autoriteti siguron që analiza të nisë brenda 20 ditëve nga vlerësimi fillestar (...).

5) Çdo **NJIF që refuzon të marrë pjesë** në kryerjen e analizës së **përbashkët duhet të japë arsyet (...)**. Autoriteti ia përcjell këtë shpjegim pa vonesë NJIF-it që ka identifikuar nevojën për analizë të përbashkët.

6) Me pëlqimin e shprehur të të gjithë NJIF-eve që marrin pjesë në analizën e **përbashkët, (...)** Autoritetit që mbështet **analizën e përbashkët i jepet akses në të gjitha të dhënat (...)**. Kur një NJIF refuzon t'i japë akses Autoritetit (...), ai sigurohet që informacioni të jepet ndryshe (...). Kur disa NJIF-e refuzojnë të japin akses në të dhëna (...), Autoriteti rivlerëson nëse detyrat që do të kryente stafi i tij justifikojnë mbështetjen e tij. (...)

8) **Me pëlqimin e shprehur të të gjitha NJIF-eve pjesëmarrëse (...), Autoriteti (...)** autorizohet të kryejë krahasime, mbi bazën e sistemit **hit no-hit**, ndërmjet të dhënave të këtyre NJIF-eve dhe të dhënave të vëna në dispozicion nga NJIF-e të tjera dhe nga organe, zyra dhe agjenci të **Bashkimit Europian, brenda mandateve të tyre** përkatëse. (...) Në rast të një hit-i, Autoriteti ndan me të gjitha NJIF-et pjesëmarrëse në analizën e përbashkët informacionin që ka shkaktuar **hit-in (...)**.

Ky nen krijon një kuadër të strukturuar të Bashkimit Europian për hetimet financiare ndërkufitare. Rregullorja vendos afate të rrepta (p.sh. 5 ditë për të njoftuar NJIF-et) për të siguruar që *informacioni* të përpunohet ndërsa është ende i përdorshëm.

NJIF-et që refuzojnë të marrin pjesë në analizën e përbashkët duhet të japin arsyet me shkrim, duke shtuar një nivel transparence dhe duke parandaluar pengesat ndaj bashkëpunimit.

Sistemi *hit-no hit* është një mekanizëm shkëmbimi informacioni i përdorur kryesisht në autoritetet e zbatimit të ligjit dhe në bazat administrative të të dhënave për të përcaktuar nëse informacioni për një person ose objekt të caktuar ekziston në një sistem tjetër, pa zbuluar menjëherë detajet e plota dhe të ndjeshme. Ai është një mjet që ruan privatësinë dhe është projektuar për të nxitur bashkëpunimin duke ruajtur standardet e mbrojtjes së të dhënave. Mund të përdoret gjithashtu për të shmangur hetimet e mbivendosura dhe procedurat e dyfishta. Në kontekstin e AMLA-s, ai lejon krahasimin e të dhënave të anonimizuara me të dhënat e mbajtura nga NJIF-e të tjera ose organe të Bashkimit Europian. Siç përmendet në konsideratën 45, kjo u mundëson hetuesve të përcaktojnë në kohë reale nëse një subjekt është i njohur në një juridiksion tjetër pa përpunim të panevojshëm të të dhënave personale. Vetëm kur ndodh një *"hit"* ndahet informacioni specifik që e ka shkaktuar përputhjen, duke siguruar që shkëmbimi i thelluar i të dhënave të jetë i përcaktuar, proporcional dhe i kufizuar rreptësisht në atë që është e nevojshme për kryerjen e analizës së përbashkët.

Kërkesa e Autoritetit për fillimin e një analize të përbashkët

Neni 42

- 1) Kur **Autoriteti identifikon** nevojën e mundshme për të kryer një analizë të përbashkët (...), **ai informon NJIF-et përkatëse** dhe u kërkon atyre të marrin pjesë në analizën e përbashkët.
- 2) NJIF-et përkatëse informojnë Autoritetin pa vonesë, duke bërë përpjekjet më të mira për ta bërë këtë brenda pesë ditëve nga marrja e kërkesës, për vendimin e tyre (...).
- 3) Kur një NJIF, së cilit i është kërkuar të marrë pjesë në analizën e përbashkët, refuzon një kërkesë të bërë nga Autoriteti (...), duhet të informojë Autoritetin për arsyet e vendimit pa vonesë, duke bërë përpjekjet më të mira për ta bërë këtë brenda pesë ditëve nga marrja e kërkesës.

Ky nen i jep AMLA-s një rol proaktiv në identifikimin e rasteve ndërkufitare që kërkojnë veprim kolektiv. Edhe pse AMLA nuk mund ta imponojë pjesëmarrjen, ajo mund ta kërkojë atë zyrtarisht. Kërkesa që njësitë kombëtare të inteligjencës të japin arsye formale për refuzimin, siguron transparencë dhe dekurajon mosbashkëpunimin arbitrar në hetime të ndërlikuara që prekin disa juridiksione.

Rishikimi i metodave, procedurave dhe kryerjes së analizës së përbashkët

Neni 43

- 2) **NJIF-et** që kanë marrë pjesë ose janë përfshirë në një formë tjetër në një **analizë të përbashkët mund t'i japin Autoritetit vlerësimet e tyre mbi mënyrën e kryerjes së analizës**, përfshirë **vlerësimet mbi mbështetjen** operacionale të ofruar nga Autoriteti (...), si edhe **vlerësimet mbi rezultatin e analizës, metodave dhe procedurave** në fuqi (...), **mjetet e disponueshme** dhe koordinimin ndërmjet NJIF-eve pjesëmarrëse (...).
- 3) (...) **Mbi bazën e vlerësimeve** (...) ose me nismën e vet, Autoriteti **mund të nxjerrë një raport pasues**. (...) Raporti pasues ndahet me **të gjitha NJIF-et** (...). Konkluzionet dhe rekomandimet (...) ndahen me të gjitha NJIF-et që kanë marrë pjesë në analizën e përbashkët (...), për aq sa ato (...) nuk përmbajnë informacion konfidencial ose të kufizuar.

Kjo dispozitë krijon një mekanizëm përmirësimi të vazhdueshëm për operacionet e inteligjencës në nivel të Bashkimit Europian. Duke vendosur një cikël përshtypjesh ndërmjet AMLA-s dhe njësitë kombëtare pjesëmarrëse, Rregullorja siguron që metodat për analizën e përbashkët të mbeten efektive kundrejt kërcënimeve kriminale në zhvillim. Raportet pasuese shërbejnë për të identifikuar dhe ndarë praktikatat më të mira ndërmjet të gjithë NJIF-eve të Bashkimit Europian, pa cenuar konfidencialitetin e rasteve specifike.

Delegatët kombëtarë të NJIF-eve

Neni 44

- 1) **NJIF-i i çdo Shteti Anëtar duhet të delegojë një ose më shumë anëtarë të stafit pranë Autoritetit (...).**
- 2) **Të dërguarit e NJIF-eve duhet të kenë statusin e stafit të NJIF-it delegues (...)** [dhe] duhet t'u jepet (...) **akses në të dhënat dhe informacionin e Autoritetit.**
- 4) **Të dërguarëve të NJIF-eve duhet t'u jepet akses në çdo të dhënë që është e aksesueshme nga NJIF-i që i ka deleguar (...).**
- 6) Bordi Ekzekutiv duhet të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet e të dërguarit të NJIF-it në marrëdhënie me Autoritetin.

Kjo dispozitë kërkon praninë fizike të ekspertëve kombëtarë në ambientet e AMLA-s. Ky personel i dërguar vepron si urë lidhëse, duke ruajtur aksesin në bazat e të dhënave të vendit të tyre për të mbështetur detyrat e AMLA-s për analizën dhe koordinimin në shkallë të Bashkimit Europian.

Ndihma e ndërsjellë në fushën e bashkëpunimit ndërmjet NJIF-eve

Neni 45

- 1) Në kuadër të nxitjes së bashkëpunimit ndërmjet NJIF-eve dhe mbështetjes së punës **së tyre, Autoriteti**, duke marrë parasysh nevojat e **NJIF-eve, duhet të promovojë qasje, metoda dhe praktika të përbashkëta** më të mira. Autoriteti duhet të organizojë dhe të lehtësojë, në veçanti, veprimtaritë e mëposhtme:
 - (a) **programe trajnimi**, përfshirë ato lidhur me inovacionin teknologjik;
 - (b) **skema shkëmbimi** dhe komandimi të personelit;
 - (c) **shkëmbim praktikash** ndërmjet NJIF-eve;
 - (d) zhvillim ose prokurim **mjetesh IT**;
- 2) Një NJIF mund t'i paraqesë Autoritetit një kërkesë për asistencë lidhur kryerjen e detyrave të tij (...) 3) Autoriteti duhet të bëjë çdo përpjekje për të ofruar asistencën e kërkuar, përfshirë vendosjen në dizpozicion të burimeve njerëzore të veta, si edhe duke koordinuar dhe lehtësuar ofrimin e çdo forme asistence nga NJIF-e të tjera mbi bazë vullnetare.

Ky nen shkon përtej bashkëpunimit të thjeshtë; ai krijon një kuadër ndihme të ndërsjellë ku njësitë individuale mund të kërkojnë mbështetje operacionale ose personeli.

<p>Ndërmjetësimi ndërmjet NJIF-eve Neni 46</p>	<p>Kjo dispozitë vendos një mekanizëm të strukturuar ndërmjetësimi për të zgjidhur konfliktet operacionale që mund të pengojnë qarkullimin e inteligjencës financiare në të gjithë Bashkimin Europian. Kur njësitë kombëtare nuk mund të zgjidhin një mosmarrëveshje lidhur me shkëmbimin e informacionit ose bashkëpunimin përmes dialogut të drejtpërdrejtë, AMLA ndërhyr për të ofruar një forum neutral pajtimi. Rregullorja siguron përgjegjshmëri duke u kërkuar njësitë të përfshira të raportojnë brenda tre muajve se si i kanë trajtuar gjetjet e ndërmjetësimit, duke u siguruar që mosmarrëveshjet operacionale të ndiqen dhe menaxhohen zyrtarisht në nivel të Bashkimit Europian.</p>
<p>1) Autoriteti mund të lehtësojë gjetjen e një zgjidhjeje në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet dy ose më shumë NJIF-eve lidhur me raste individuale të bashkëpunimit, përfshirë shkëmbimin e informacionit (...). Qëllimi i këtij ndërmjetësimi është pajtimi i pikëpamjeve të ndryshme ndërmjet NJIF-eve dhe miratimi i një opinioni jo detyrues.</p> <p>2) Kur një mosmarrëveshje nuk mund të zgjidhet përmes kontaktit dhe dialogut të drejtpërdrejtë ndërmjet NJIF-eve përkatëse, Autoriteti nis një procedurë ndërmjetësimi me kërkesë të një ose më shumë prej këtyre NJIF-eve.</p>	<p>Rregullorja i cakton AMLA-s përgjegjësinë teknike për FIU.net për të siguruar përdorimin e teknologjisë së përditësuar, duke kufizuar në mënyrë të rreptë aksesin e AMLA-s në komunikimet private ndërmjet njësitë kombëtare.</p>
<p>FIU.net Neni 47</p> <p>1) Autoriteti duhet të sigurojë administrim, mirëmbajtje dhe zhvillim të FIU.net në mënyrë të përshtatshme, të pandërprerë dhe të sigurt.</p>	<p>Procesi i vlerësimit ndërmjet kolegëve vlerëson objektivisht nëse njësitë kombëtare kanë pavarësinë, personelin dhe sigurinë IT të nevojshme për të funksionuar në mënyrë efektive brenda kuadrit të Bashkimit Europian.</p>
<p>Vlerësim ndërmjet kolegëve Neni 48</p> <p>Autoriteti krijon një proces vlerësimi ndërmjet kolegëve për veprimtaritë e NJIF-eve (...).</p>	

Bordi i Përgjithshëm

Seksioni 1 (Kreu III)

Neni 57

1) Bordi i Përgjithshëm ka ose strukturë mbikëqyrëse (...) ose strukturën e NJIF-eve (...).

3) Bordi i Përgjithshëm me strukturën e NJIF-eve përbëhet nga: (...)

(b) drejtuesit e NJIF-eve, me të drejtë vote

Neni 58

4) Bordi i Përgjithshëm me përbërjen e NJIF-eve krijon një komitet të përhershëm (...) për të mbështetur kryerjen e detyrave të tij (...), duke paraqitur propozime dhe përgatitur projektvendime.

Neni 59

1) (...) anëtarët e Bordit të Përgjithshëm (...) me strukturën e NJIF-eve veprojnë si një tërësi dhe nuk kërkojnë e as nuk marrin udhëzime nga institucionet e Bashkimit Europian (...) apo nga ndonjë qeveri.

Neni 60

3) Bordi i Përgjithshëm me strukturën e NJIF-eve kryen detyrat dhe miraton vendimet e përmendura në nenin 5(5) dhe Kreun II, Seksionin 6.

Bordi i Përgjithshëm është organi kryesor vendimmarrës i AMLA-s, përgjegjës për miratimin e rregullave të harmonizuara dhe politikave të koordinimit. Për të garantuar ekspertizë të specializuar, ai ndahet në dy përbërje:

- **Bordi i Përgjithshëm me strukturë mbikëqyrëse:** përbëhet nga kryetari dhe drejtuesit e mbikëqyrësve kombëtarë për çështjet e mbikëqyrjes.
- **Bordi i Përgjithshëm me përbërje të NJIF-eve:** me Kryetarin dhe drejtuesit e NJIF-ve kombëtare për koordinimin e inteligjencës financiare. Bordi mbështetet nga një komitet i përhershëm prej 9 ekspertësh të NJIF-ve që përgatisin projektvendime teknike.

Të gjithë anëtarët duhet të veprojnë me pavarësi të plotë, duke i dhënë përparësi interesave të Bashkimit Europian ndaj çdo udhëzimi të jashtëm ose qeveritar.

Llogaridhënia dhe raportimi

Neni 84

4) (...) Autoriteti (...) duhet t'i vërë në dispozicion Parlamentit Europian një evidencë gjithëpërfshirëse dhe domethënëse të punimeve të atij takimi (...). Një evidencë e tillë nuk duhet të pasqyrojë (...) të dhëna që lidhen me NJIF-et, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në aktet legislative (...).

Ky nen siguron që AMLA të japë llogari para institucioneve të Bashkimit Europian për kryerjen e detyrave të saj. Për të ruajtur transparencën, ajo duhet të publikojë raporte vjetore dhe të ndajë evidencën e takimeve të saj të nivelit të lartë. Megjithatë, për të mbrojtur integritetin e NJIF-eve, AMLA-s i ndalohet të zbulojë të dhëna konfidenciale që lidhen me NJIF-et, me qëllim që kërkesat e raportimit të mos cenojnë sigurinë e hetimeve në vijim.

Bashkëpunimi me vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare

Neni 95

1) (...) **Autoriteti mund të zhvillojë kontakte** dhe të lidhë marrëveshje administrative me autoritete **AML/CFT në vende të treta që kanë kompetenca rregullatore**, mbikëqyrëse, dhe kompetenca që lidhen me NJIF-et (...), si edhe me organizata ndërkombëtare dhe administrata të vendeve të treta.

2) Autoriteti mund të hartojë modele marrëveshjesh administrative (...) NJIF-et duhet të bëjnë çdo përpjekje për t'i ndjekur këto modele.

3) Në rastet kur ndërveprimi ndërmjet (...) disa autoriteteve mbikëqyrëse të Bashkimit Europian dhe NJIF-eve me (...) autoritete të vendeve të treta lidhet me çështje që bien brenda fushës së detyrave të Autoritetit (...), **Autoriteti ka rol udhëheqës në lehtësimin e këtij ndërveprimi**, kur është e nevojshme.

4) **Autoriteti (...) kontribuon** në përfaqësimin e **bashkuar, të përbashkët, të njëtrajtshëm dhe efektiv** të interesave të Bashkimit europian në forumet ndërkombëtare (...), **duke mbështetur punën dhe objektivat** e Grupit Egmont të **Njësive të Inteligjencës Financiare**.

Ky nen e pozicionon AMLA-n si përfaqësuesen qendrore të interesave të Bashkimit Europian në fushën e inteligjencës financiare në arenën ndërkombëtare. Kjo përfshin ofrimin e mbështetjes specifike për Grupin Egmont, i cili është rrjeti kryesor ndërkombëtar për shkëmbimin e informacionit ndërmjet NJIF-eve.

Vlerësimi dhe rishikimi

Neni 102

1) **Deri më 31 dhjetor 2030, dhe çdo pesë vjet më pas, Komisioni harton një raport mbi performancën e Autoritetit (...).** Ky raport trajton, në veçanti:

(c) **ndikimin e veprimtarive që lidhen** me mbështetjen dhe koordinimin e NJIF-eve, dhe në veçanti koordinimin e analizave të përbashkëta të aktiviteteve dhe transaksioneve ndërkufitare të kryera nga NJIF-et.

2) **Raporti (...)** shqyrton gjithashtu nëse:

(c) është e **përshtatshme t'i jepen Autoritetit detyra shtesë** në fushën e mbështetjes dhe koordinimit të punës së NJIF-eve.

Ky nen vendos një auditim të detyrueshëm të performancës. Rishikimi është konceptuar me vështrim nga e ardhmja; nëse mekanizmi i mbështetjes dhe koordinimit rezulton i suksesshëm, Komisioni mund të rekomandojë zgjerimin e mandatit dhe kompetencave të AMLA-s.

SHËNIME NË FUND

- [Chasing Grand Corruption](#) përfshin informacion mbi autorin/redaktorin nga kreu i PDF-së së raportit (Isabelle Böhchner si autore).
- [The Transparency France International case study](#) është një botim online i datës 15 tetor 2025.
- [European Parliament and Council of the European Union](#).2024. Direktiva (BE) 2024/1640 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 31 maj 2024, mbi mekanizmat që duhet të vendosen nga Shtetet Anëtare për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit. Gazeta Zyrtare e Bashkimit Europian, OJ L 2024/1640, 19 qershor.



Transparency International EU

31 Rue du Commerce, 1000 Brussels

<http://www.transparency.eu/>

+32 (0) 4 97 49 90 81

brussels@transparency.org

Transparency Register ID: 501222919
71